



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 34 paragrafi 1 shkronja d e Statutit të Komunës së Prishtinas, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2016, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË
PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2017

I.

MIRATOHET vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017.

II.

Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Halim Halimi, **kryesues**,
2. Shefki Gashi (LDK), anëtar,
3. Lirie Avdiu (PDK), anëtare,
4. Sylejman Pireva (LVV), anëtar,
5. Rita Begolli (AAK), anëtare,
6. Sami Boroci (AKR), anëtar,
7. Abetare Fazliu (LB), anëtare,
8. Kimet Zeqa (PD), anëtare,
9. Visar Arifaj (PF), anëtar,
10. Nenad Miladinoviq (G.I.S), anëtar,
11. Ardian Olluri, Udhëheqës i Zyrës ligjore, anëtar,
12. Osman Bllaca, auditor i brendshëm, anëtar,
13. Zijadin Gashi, shef i sektorit për punë të kuvendit, anëtar.

III.

Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij Vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës, me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve të tjera – pjesën me kompetencë të Komunës,

aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017. Pas hartimit të planit final grupi punues, do ta prezantojë planin para Kuvendit të Komunës për miratim.

IV.

Afati për dorëzim të planit vjetor final është 15 ditë nga dita e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 031-311327, më 22.12.2016

KRYESUESI I KUVENDIT

Halim Halimi, jur. i dpl.